REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

REPUBLIKA E KOSOVËS
VENDIMI ËSHTË I PRAPËSUESHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NOVOBËRDË
OSNOVNI SUD GNJILANE - ODJELJENJE NOVO BRDO
10.10.2019

Numri i lëndës: 2018:037810

Datë: 30.07.2019

Numri i dokumentit: 00433519

P.nr.35/2018

Gjykata Themelore në Gjilan.Dega në Novobërdë-Departamenti i përgjithshem, *me gjyqtaren e vetme gjykuese Emine Salihu, me procesmbajtësin Ref.i Lartë Naim Keka, në qështjen penale kundër të pandehurit [redacted], nga [redacted],për shkak të vepres penale Rezikimi i trafikut publik nga neni 378 parag.6 lidhur me parag 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelorenë Gjilan, Departamenti i përgjithshëm me nr.PP.II.nr.906/2018 të datës 16.07.2018, jasht seancës dhe sipas detyrës zyrtare, me datë 18.07.2019, mori këtë;*

A K T V E N D I M

I. HUDHET- *Aktakuza e Prokuroris Themelore në Gjilan- Departamenti i përgjithsem me nr PP.II.nr.906/2018 të datës 16.07.2018, dhe*

II.PUSHOHET- *Procedura penale ndaj të pandehurit [redacted], nga Prizreni [redacted]"Nr [redacted], për shkak të vepres penale Rezikimi i trafikut publik nga neni 378 parag.6 lidhur me parag 1 të KPRK-së, për shkak se vepra penale për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale sipas Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës me numer 06/L-074,të hyrë në fuqi me datë 14.04.2019.*

III. *Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohen në kontest të rregullt civilo juridik.*

IV.*Shpenzimet e procedures penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.*

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshem me datë 16.07.2018, ka ngritur Aktakuzen me numër nr PP.II.nr.906/2018, kundër të pandehurit [redacted], nga Prizreni Rr"[redacted]"Nr.50, për shkak të vepres penale Rezikimi i trafikut publik nga neni 378 parag.6 lidhur me parag 1 të KPRK-së.

Duke u bazuar në Kodin Penal të R.Kosovës me numër 06/L-074, të datës 13.12.2018, të miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës,ndërsa i hyr në fuqi me datën 14.04.2019, gjykata gjeti se veprimet inkriminuese të të pandehurit të lartëcekur, nuk përbëjnë vepër penale sipas nenit 378 paragrafi 1

2018:037811

të KPRK-së, ngase në këtë nen thuhet se ***"Kush do që shkel Ligjin mbi Trafikun Publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerzve apo pasurin dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm pasuror, denohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet(3)"****, qka nënkupton se veprimet të cilat kan pasur si pasoj shkaktimin e lëndimit trupor të kryer me rastin e shkeljes së Ligjit mbi trafikun Publik apo transportin rrugor e të cilat kan qen të parapara me nenin 378 paragrafin 1 të KPRK-së, të shfuqizuar më nuk përbëjnë vepër penale, gjithë ashtu duke patur parasysh se sipas nenit 3 paragrafit 2 të KPRK-së në të cilën thuhet se "Në rastë se Ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formes së prerë, atëher ndaj kryersit zbatohet ligji që është më i favorshem",si dhe faktin se zbatimi i veprimit retroaktiv të ligjit është obligim i gjykates, dhe se me rastin e ndryshimit të ligjit duhet të zbatohet ligji më i favorshem për të pandehurin, gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret veprimet inkriminuese të parapara me nenin 378 parag.1të KPRK-së, së shfuqizuar (Përkatësisht shkaktimi i lëndimit të leht truporme rastin e shkeljes së Ligjit mbi Trafikun Publik apo transportit rrugor), sipas Kodit të ri Penal,nuk paraqesin vepër penale dhe si rrjedhoj ndaj kryesve të këtyre veprave penale më nuk mund të ndërmirret ndjekja penale dhe as të iu shqiptohet denimi i parapar ligjor.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit 253 parag.1 pika 1.1 të KPPK-së dhe nenit 3 paragrafi 2 të KPRK-së, vendosi që ta hudh posht Aktakuzen e Prokurorisë Themelore në Gjilan, dhe ndaj të pandehurit të lartëcekur të pushohet procedura penale për vepren penale e cila i vihet në barrë.

Gjykata Themelore Gjilan.Dega në Novobërdë,
Departamenti i përgjithëshem
P.nr.35/2018, Me date 18.07.2019

Procesmbajtësi
Ref.i Lartë ,
Naim Keka

Gjyqtarja
Emine Salihu

KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij aktvendimi ,mund të ushtrohet ankesë në Gjykaten e Apelit të Kosovës, mbrenda afatit prej 5 ditëve nga dita e pranimit të Aktvendimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate Themelore.*